



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, Trupi Gjykses më 18 dhjetor 2025 hodhi poshtë një kërkesë të Prokurorisë për të paraqitur kundërprova. Trupi Gjykses gjykoi se Prokuroria nuk provoi se kërkesa ishte në interes të drejtësisë dhe se kishte të bënte me një aspekt të rëndësishëm që buron drejtpërdrejt nga provat e Mbrojtjes. Gjithashtu, Trupi Gjykses ishte i mendimit se këto prova ishin të disponueshme për Prokurorinë më parë dhe se Prokuroria mund të kishte kërkuar leje për të ndryshuar listën e vet të provave materiale në një fazë të mëhershme, si pjesë e provave të veta dhe jo si kundërprova.

Gjithashtu më 18 dhjetor, Trupi Gjykses e deklaroi të mbyllur procesin e paraqitjes së provave në këtë çështje. Trupi Gjykses vuri në dukje se palët dhe Mbrojtja e Viktimave kanë paraqitur provat e tyre dhe se nuk ka dëshmitarë të tjerë për t'u thirrur apo prova të tjera për t'u paraqitur. Trupi Gjykses rikujtoi urdhrin e vet drejtuar palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave për dorëzimin e Dosjeve Gjyqësore Përfundimtare dhe Deklaratën e Pasojave, deri të hënën 19 janar 2026.

Trupi Gjykses caktoi gjithashtu kalendarin për deklaratat përmbyllëse nga data 9 deri më 13 shkurt, dhe më 16 dhe 18 shkurt. Pas shqyrtimit të parashtrimeve të palëve dhe pjesëmarrësve lidhur me vlerësimet kohore për deklaratat përmbyllëse, Trupi Gjykses caktoi 8 orë për deklaratën përmbyllëse të Prokurorisë; 3 orë për deklaratën e Mbrojtjes së Viktimave dhe nga 4.5 orë për secilin ekip të Mbrojtjes.

Trupi Gjykses theksoi se mund të kërkojë sqarime për çdo aspekt të paraqitur në dosjet gjyqësore përfundimtare dhe njoftoi se, përpara deklaratave përmbyllëse, do të nxjerrë një urdher me shkrim në të cilin do të paraqesë pyetjet e mundshme për palët dhe pjesëmarrësit. Palët dhe pjesëmarrësit pritët të përfshijnë përgjigjet ndaj pyetjeve të Trupit Gjykses në deklaratat e tyre përmbyllëse. Trupi Gjykses do të ketë edhe dy orë të tjera të rezervuara për pyetje shtesë të mundshme të patrajtuara në deklaratat përmbyllëse të palëve dhe pjesëmarrësve ose që burojnë nga argumentet dhe parashtrimet e bëra gjatë këtyre deklaratave.

Duke qenë se palët kanë të drejtën të përgjigjen ose të japin komente mbi deklaratat përmbyllëse të njëra-tjetrës, Trupi Gjykses ka caktuar 2.5 orë të tjera për parashtrime të tilla nga Prokuroria, 30 minuta për secilin ekip të Mbrojtjes dhe 20 minuta shtesë për çdo të akuzuar. Nëse Mbrojtja e Viktimave do të dëshirojë të përgjigjet, mund të kërkojë leje nga Trupi Gjykses gjatë seancës nëse dhe kur e vlerëson të nevojshme.

Bazuar në sa më lart, kalendari aktual për deklaratat përmbyllëse paraqitet si më poshtë:
Të hënën, 9 shkurt, Prokuroria do të paraqesë deklaratën e vet përmbyllëse.





Të martën, 10 shkurt, Prokuroria do të përfundojë paraqitjen e deklaratës së vet përmbyllëse dhe Mbrojtja e Viktimave do të paraqesë deklaratën e vet përmbyllëse.

Dita e enjte, 11 shkurt është rezervuar për deklaratën përmbyllëse të Mbrojtjes së Thaçit dhe të një pjese të deklaratës së Mbrojtjes së Veselit.

Të enjten, 12 shkurt, Mbrojtja e Veselit do të do të përfundojë paraqitjen e deklaratës së vetj përmbyllëse, dhe Mbrojtja e Selimit do të fillojë me deklaratën e vet.

Të premten, 13 shkurt, Mbrojtja e Selimit do të përfundojë paraqitjen e deklaratës përmbyllëse dhe Mbrojtja e Krasniqit do të fillojë me të vetën.

Dita e hënë, 16 shkurt është rezervuar për përfundimin e deklaratës përmbyllëse të Mbrojtjes së Krasniqit dhe pyetjet e Trupit Gjykses, nëse do të ketë.

Të mërkurën, 18 shkurt, palët do të kenë kohë t'u përgjigjen deklaratave përmbyllëse të palës tjetër dhe të akuzuarit do të kenë mundësinë të bëjnë një deklaratë. Pas kësaj, Trupi Gjykses do të mbyllë çështjen.

Ky rend dite bazohet në vlerësimet aktuale dhe mund të ndryshojë, për shembull nëse një palë ose pjesëmarrës ka nevojë për më pak kohë seç mendohej.

Trupi Gjykses urdhëroi të akuzuarit që, nëse dëshirojnë të flasin, të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit, dhe theksoi se deklaratat politike apo komentet fyese ndaj palëve, pjesëmarrësve, dëshmitarëve ose viktimave nuk do të tolerohen.

Në të njëjtën çështje, përkatësisht më 19 dhe 29 dhjetor, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesat e Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit për mbrojtje të ligjshmërisë. Kërkesat u dorëzuan në fund të vitit 2025, pas lënies në fuqi nga Dhoma e Apelit të vendimeve të Trupit Gjykses për vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli dhe z. Krasniqi. Dy të akuzuarit argumentuan ndër të tjera se Paneli i Apelit nuk kishte vlerësuar siç duhet rreziqet që përligjin mbajtjen e tyre në paraburgim. Megjithatë, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Paneli i Apelit kishte vlerësuar siç duhet ekzistencën e vazhdueshme të rreziqeve relevante në kohën e shqyrtimit dhe kishte dhënë arsyetim thelbësor që vërtetonte se rreziku i pengimit vazhdon të ekzistojë.

Më 29 dhjetor, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të z. Veseli për leje për të apeluar një vendim të mëparshëm të Trupit Gjykses me anë të të cilit, bazuar në kërkesën e Thaçit, u pranua si provë një deklaratë me shkrim e një dëshmitari. Z. Veseli vlerëson se kjo deklaratë e dëmton atë. Ndër të tjera, Trupi Gjykses konstatoi se ka trajtuar çdo ndikim të dëmshëm të mundshëm ndaj cilitdo të akuzuar kur gjykoi se deklarata përkon me prova të tjera që palët kanë pasur mundësi t'i kundërshtojnë në gjykatë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykoi se z. Veseli thjesht nuk pajtohej me vendimin e mëparshëm të Trupit Gjykses, por nuk provoi ndonjë gabim ligjor të mundshëm.

Duke qenë se paraqitja e deklaratave përmbyllëse në çështjen *Thaçi dhe të tjerë* po afrohet, dëshirojmë të rikujtojmë disa të dhëna bazë lidhur me këtë çështje.





Në nëntor 2020, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u arrestuan pas konfirmimit të një aktakuze dhe lëshimit të fletarrestimeve nga një gjykatës.

Prokuroria pretendon se të akuzuarit mbajnë përgjegjësi individuale për rrëmbimin, keqtrajtimin dhe vrasjen e qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime. Pretendohet se këtu përfshiheshin persona që konsideroheshin se bashkëpunonin me forcat jugosllave dhe kundërshtarë politikë.

Gjatë fazës paraprake, Prokuroria i tregoi Mbrojtjes mijëra faqe prova. Mbrojtja kreu hetimet e veta dhe ngriti kundërshtime ligjore ndaj aktakuzës dhe juridiksionit të gjykatës. Viktimat aplikuan për të marrë pjesë. Në proces marrin pjesë 155 viktima.

Midis prillit 2023 dhe prillit 2025, Prokuroria thirri 125 dëshmitarë. Midis shtatorit dhe nëntorit 2025, ekipet e Mbrojtjes thirrën 7 dëshmitarë. Secila palë pati mundësinë të bëjë pyetje dhe të kundërshtojë dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga pala tjetër.

Sipas ligjit, një i akuzuar mund të mbahet në paraburgim vetëm nëse gjykatësit konstatojnë se ekzistojnë rreziqe që e përligjin atë. Deri tani, në më shumë se 25 rishikime të paraburgimit, gjykatësit kanë konstatuar se z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë paraqisnin rrezik të kryerjes së veprave penale të tjera, konkretisht kundër personave që kishin dhënë dëshmi ose që pritej të jepnin dëshmi para Dhomave të Specializuara. Gjykatësit kanë theksuar gjithashtu se paraburgimi synon të parandalojë rrezikun e hakmarrjes kundër dëshmitarëve ose përpjekjet për të nxitur një dëshmitar që të tërheqë dëshminë e tij. Gjykatësit do të vazhdojnë të vlerësojnë çdo dy muaj nëse paraburgimi vazhdon të jetë i nevojshëm për trajtimin e këtyre rreziqeve.

Sa i takon parimit të procesit publik, pjesa më e madhe e 134 dëshmitarëve që dhanë dëshmi në sallën e gjyqit gjatë gjyqimit, e bënë këtë tërësisht ose kryesisht në seancë publike, 61 prej këtyre dëshmitarëve dhanë dëshmi pas asnjë masë mbrojtëse.

Dëshmitë që u dhanë në seancë private po rishikohen në vazhdimësi dhe, kur është e mundur, riklasifikohen, dhe po nxirren në vazhdimësi transkripte me më pak redaktime, për të siguruar që procesi të jetë publik dhe të mund të përcillet nga çdo person i interesuar.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm i caktuar për gjykim, përkatësisht më 19 dhe 22 dhjetor rrëzoi kërkesat e ndërmjetme të z. Fazliu dhe z. Smakaj për të rishikuar mbajtjen e tyre në paraburgim. Të dy argumentuan se janë krijuar rrethana të reja pasi koha që ata kanë kaluar në paraburgim deri tani është e njëjtë me kohën e dënimit më të ulët me të cilin do të dënoheshin nëse shpallen fajtor për veprat penale për të cilat akuzohen. Gjykatësi i Vetëm konstatoi se këto rrethana ishin të ditura





dhe mund të ishin paraqitur si argument gjatë rishikimeve të fundit të paraburgimit të tyre çdo dy muaj. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm gjykoi se argumentet nuk përligjin rishikim të ndërmjetëm të paraburgimit. Sidoqoftë, ai inkurajoi palët që të sigurohen që parashtrimet e tyre për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit çdo dy muaj të jenë të plota dhe të përditësuara.

Më 22 dhjetor, Gjykatësi i Vetëm miratoi Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit në këtë çështje në të cilin ai trajtoi aspekte që kanë të bëjnë me parimin e procesit publik, pranimin e provave, dhe përgatitjen e dëshmitarëve dhe dëshmitë. Ndër të tjera, Gjykatësi i Vetëm vendosi që, në përputhje me natyrën publike të gjykimit, palët duhet të përpiqen që, kur është e mundur, parashtrimet me shkrim t'i paraqesin si dokumente publike dhe që të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur numri i seancave private dhe të mbyllura. Versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara duhet të dorëzohen jo më vonë se tri ditë pas dorëzimit të parashtrimit origjinal. Transkriptet e seancave do të rishikohen dy javë pas përfundimit të secilit bllok provash për të vlerësuar nëse redaktimet, nëse do të ketë, mund të hiqen në tërësi ose pjesërisht.

Masat mbrojtëse për dëshmitarë, të vendosura nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbeten në fuqi dhe kërkesat e tjera lidhur me këto masa duhet të bëhen jo më vonë se në kohën e dorëzimit të listës përfundimtare të dëshmitarëve. Kontakti midis dëshmitarëve dhe palëve do të jetë i ndaluar nga momenti kur dëshmitari bën betimin solemn në fillim të dhënies së dëshmisë së vet.

Më 30 dhjetor, Kryetare Trendafilova caktoi gjykatësit Vidar Stensland, Roumen Nenkov dhe Piotr Hofmanski në një panel të Gjykatës Kushtetuese pas kërkesës referuese të z. Thaçi pasi Paneli i Gjykatës së Apelit kishte rrëzuar apelin e tij në të cilin kundërshtojë caktimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake në këtë çështje.

Më 7 janar, Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes për zgjatjen e afatit dhe shtimin e numrit të fjalëve për përgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorirë për Prova Jogojore i datës 17 dhjetor në të cilin Prokuroria kërkoi pranimin si prova të më shumë se 30 materialeve që nuk lidhen me asnjë dëshmi dëshmitari.

Gjykatësi i Vetëm u bind se kishte arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit duke pasur parasysh vëllimin e materialeve të paraqitura për pranim; rëndësinë e materialeve për gjykimin; dhe vështirësitë teknike të disa materialeve.

Së fundi, si përgjigje ndaj keqinformimeve të fundit lidhur me vizitat për arsye humanitare, dëshirojmë të theksojmë se, bazuar në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, korniza ligjore e Dhomave të Specializuara të Kosovës u lejon të paraburgosurve të kërkojnë të bëjnë vizitë në Kosovë për arsye humanitare bindëse, për shembull për t'i bërë vizitë një të afërmi të sëmurë shumë rëndë. Deri tani, gjykatësit e Dhomave të Specializuara kanë urdhëruar katërmëdhjetë vizita të tilla të të paraburgosurve, të menaxhuara nga gjykata.

